



KESHILLI I BASHKISE K O R Ç E

VENDIM

Nr. 16 Date 10.05.2007

Per cakimin e koshtos mesatare te ndertimit dhe nivelin e takses se ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja.

Keshilli i Bashkise ne mbledhjen e tij te dates se sotme pasi morri ne shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban te Territorit dhe mbeshtetur ne ligjin "Per Urbanistiken" Nr. 8405 date 17.09.1998, ndryshuar me ligjin Nr.8501, date 16.06.1999, "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr.8405, date 17.09.1998 "Per Urbanistiken", Neni 51, paragrafi 1, ne ligjin Nr. 9632, date 30.10.2006, "Per sistemin e taksave vendore".

VENDOSI :

- I. Te miratoje llogaritjen e takses prej 1 % te vleres se investimit qe do te kryeje sipas koshtos mesatare te ndertimit te Entit Kombetar te Banesave per vitin perkates. Ky fond depozitohet per llogari te financimit te studimeve urbanistike ne pushtetin vendor.
- II. Te miratoje nivelin e takses se ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja ndare sipas zonave
 - ne zona me rrjet inxhinierik me te konsoliduar dhe mendojme qe niveli i kesaj takse te jete 2 %.
 - ne zona me rrjet inxhinierik me pak te konsoliduar dhe mendojme qe niveli i kesaj takse te jete 1.5 %.
 - ne zona me rrjet inxhinierik te pa konsoliduar dhe mendojme qe niveli i kesaj takse te jete 1 %.Ne kete klasifikim hyjne vetem banesat kolektive ndersa per banesat individuale niveli i llogaritjes se kesaj takse te jete ne 1 %.
Keto % do te llogariten ne baze te vleres se investimit qe do te kryhet, sipas koshtos mesatare te ndertimit te Entit Kombetar te Banesave per vitin perkates .
- III. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Urban te Territorit, Drejtoria e te Ardhurave dhe Drejtoria e Finances.

IV. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere

Rajmonda NASE

Rajmonda Nase

K R Y E T A R E